



VEND MI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNO-SNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROŠEVAC

P.nr.1715/2017

*28.02.2018*

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Pergjithshëm,**  
**Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtarin Ligjor Blend Rexhepi në çështjen**  
**penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga [REDACTED], i akuzuar me**  
**aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.173-2/16 të dt. 13.07.2017, për shkak**  
**të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-**  
**së, pas mbajtjes së shqyrtimin kryesor - gjyqësor, në pranimin e prokurorit të shtetit Bahri**  
**Hyseni, të akuzuarit me datën 15.01.2018 solli këtë :**

### A K T G J Y K I M

Kundër:

Të akuzuari [REDACTED] nga [REDACTED], i lindur me datë, [REDACTED], nga i ati [REDACTED], e emri [REDACTED] të vajzërisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer, me nr. personal [REDACTED], mbrohet në liri.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 07.02.2016, rrëth orës 10.00 në rrugën magjistrale Prishtinë- Shkup, përkatësisht përball restorant "Evropa 92", në Ferizaj, duke drejtuar automjetin transportues e tij të markës "Kia K 2500" me targa te regjistrimit [REDACTED], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 54/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, gjatë çkyqjes nga rruga magjistrale në anën e majtë për të hyrë në parkingun e restorantit, me pjesën e përparme e godet në anësoren e përparme të anës së djathë automjetin e markës "Land Rover", me targë të regjistrimit [REDACTED], e cila pastaj nga inercioni e godet veturën e markës "Mercedes", me targë të regjistrimit [REDACTED], e cila veturë ishte e parkuar, me të cilin rast pos dëmeve materiale lëndime të lehta trupore pëson [REDACTED], lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko - ligjore të datës 03.02.2017.

*- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.*

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhë neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

### DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin [REDACTED], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind euro).

Në mbështetje të nenit 46 par.5 1 të KPK-së, dënim i shqiptuar me gjobë me pëlqimin e të dënuarit ditën e komunikimit i zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme prej 80 (tetëdhjetë) orë, të cilën punë do ta kryej pa pagesë në afat prej tre muajve prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni, ka lexuar aktakuzën të akuzuarit dhe pas leximit gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi akuzën për të cilën është akuzuar dhe të njëjtë i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën për të cilën është akuzuar.

Lidhur me këtë i akuzuari [REDACTED], para se të deklarohet lidhur me proanimin ose jo të fajsisës për veprën penale për të cilën akuzohet si në dispozitiv të aktit akuzues dhe në vazhdim ka thekësuar se e kundërshtimin e ka bër kundër urdhërit ndëshkimor jo për vepren penale që akuzohet dhe i kërkon falje të dëmtuarit për lëdmet që ka pësuar dhe dëmeve materiale të veturës që i'u jan shkaktuar, por kundër shqiptimit të denimit me gjobë e në ma mundësi që ta paguaj për shkak se gjendjen ekonomike nuk e ka të mirë është i pa punë në pamundësi që ta paguaj denimin e shqiptuar me urdhëri ndëshkimor ka kërkuar nga gjykata që ti zavendëson me një dënim me kusht.

Pas kësaj gjyqtari në shqyrtimin gjyqësor pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka vlerësuar se janë përbushur kërekesat nga neni 326 par.4 i KPPK-së, pasi që i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, fajin e ka pranuar vullnetarishtë duke e mbështetur në provat dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit të cilat gjinden në shkresat e kësaj lënde penale dhe shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtarëve të palëve konform nenit 352 të KPPK-së.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Bahri Hyseni ka mbetur në tërësi pran aktakuzës së ngritur nga ana e prokurorisë si dhe kualifikimit juridik për veprën penale e cila i vehet në barrë të akuzurit, nga baza e pranimit të fajësisë nga ana e tij i cili pranim gjenë mbeshtetje të plotë edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës i ka propozur gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ti shqiptoi sanksion penal të parapar me ligj përmes të cilit do të arrihet qëllimi ndëshkimor, ndërsa me rastin e matjes së llojit dhe lartësise së dënitit si rrethana lehtësuese të akuzuarit ti merr pranimin e fajësisë nga ana e tij gjendjen ekonomike që e përshkroj gjatë deklarimit mbi pranimin e fajsisë së dhënë dhe premitimet se në të ardhmen do të ketë kujdes gjatë vozitjes.

I akuzuari [REDACTED], në fjalën përfundimtare ka mbetur pran asaj se e ndien vreten fajtorë dhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj sanksion penal më të butë pasi është i gjendjes së varfér ekonomike dhe nuk është i pa punë.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor konstatoi se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe ate në konstatimin e ekspertit mjeko ligjor i dt.03.02.2017, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 20.12.2016, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë, pendimin e kryerjes së veprës penale, i pa punë, sjelljen e tij korrekte në seancën gjyqësore, ka premtuar se vepra të tilla më nuk do të përsërisë, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, të akuzuarit i shqiptoj dënimin në shumën prej 200 Euro.

Bzuar në nenin 46 par.5. I të KPK-së, dënim i shqiptuar me gjobë me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësoshet me punë në dobi të përgjithshme prej 80 (tetëdhjetë) orë, të cilën punë do ta kryej pa pagesë në afat prej tre muajve prej ditës së fillimit të ekzekutimit, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjeneralë, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit që i akuzuari të mos kryejë vepra penale të tjera të parandalimit konform nenit 41 të KPRK-së.


Gjkata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarit [REDACTED] nga [REDACTED], për realizimin e kërkësës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 €uro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,  
P.nr.1715/2017 me dt.15.01.2018

Zyrtari Ligjor  
Blend Rexhepi



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundërshtarët mundë të ushtronin ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.